



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/27 Nr. i faq./Br.str./No.pg 76

Data/Datum/Date 28.03 / 2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Propozimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 02.5400/25 të datës 12.03.2025, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 merr këtë:

V E N D I M

1. **JEPET PËLQIMI** paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizik dhe juridik deri në 50 (pesëdhjetë) vite, për ushtrimin e veprimtarisë biznesore, përmes procedurës së shprehjes së interesit.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur shume-kabilja glava, me kulturë mal i klasës 5, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02240-81 në sipërfaqe të përgjithshme prej 28000m² (njëzet e tetë mijë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren me Nr. Prot. 01 Nr. 169/21 të datës 26.02.2021 dhe Rregulloren me Nr. Prot. 01 Nr. 22/23 të datës 28.02.2023.
5. Realizimi i pagesës së qirasë do të filloj pas 24 (njëzet e katër) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Parcela e cekur në pikën 1 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 2023 – 2031 me Nr. Prot. 01 Nr. 182/24 i datës 30.01.2024 ka destinin: 3. Prodhim tretësor/ 31. Shërbim tregtar/ 311. Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake.
7. **OBLIGOHET** Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur përmes shprehjes së interesit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.27/25
Me datë:28.03.2025

